

REPUBLICA E KOSOVËS /
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.385/01

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtarja Shpresa Emra, në çështjen juridike të paditësit [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] të gjithë nga Kukësi R e Shqipërisë, të cilët i përfaqëson e autorizuar av.M. [redacted], nga Prizreni, kundër të paditues Komuna e Prizrenit të cilën e përfaqëson avokati publik komunal B. [redacted], për vërtetim të pornësisë dhe kthim në posedim, vlera e kontestit 3100€, me datë 28.02.2013 mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet kërkesë padia e paditësve [redacted], [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] të gjithë [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] të gjithë nga Kukësi R e Shqipërisë, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit janë pronarë të dyqanit i cili gjindet në rrugën Ismet Jashari nr.16 në parcelën nr. 3305 KK Prizren, në tërësi si i pabazë.

Obliqohen paditësit t' i paguajnë shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësit nëpërmjet të autorizues së tyre në padi kanë cekur se babai i paditësve [redacted] [redacted] ish nga Prizren, i është dëbuar nga shtëpia e tij në Prizren, diku në vitin 1944 dhe është detyruar që të largohet në Republikën e Shqipërisë, duke lënë gjithë pasurinë e tij pra edhe lokalin i cili ka qenë plot me mall dhe në të cilën ka punuar gjerë atëherë. Ai nuk ka mund të marrë as edhe një dokument me vete përveç familjes së tij. Ky lokal gjendet në rrugën [redacted] ish [redacted] dhe në të kanë punuar si shegërt [redacted], [redacted], [redacted] i ndjeri [redacted] e të tjerë. Babai i paditësve ka qenë i përndjekur nga ana e regjimit serb- jugosllav kurse gjithashtu persekutohet edhe nga regjimi i Republikës së Shqipërisë së atëhershme dhe një kohë qëndron në burg. Për këtë fakt ka folur edhe me të përndjekurin A. [redacted] të cilit i ka treguar se e ka lënë dyqanin e vet plot me mall në Prizren. Pasi që ky lokal që nga viti 1944 ka mbetur pa pronar pronësia e tij ka kaluar nëpër duar të shumtë dhe me themelimin e kadastrit në vitin 1953 në cilësi të pronarit evidentohet Komuna e Prizrenit sipas listës pos. Nr. 8414 parc. Nr.3305 pasi që prona është e paprekur dhe mbrohet me mundësitë objektive. Paditësve tani i është dhënë mundësia që në mënyrë të drejt dhe të denjë të kthejnë lokalin të cilin e takon dhe të cilën babai i tyre e ka lënë. Këtë nuk kanë mund të bëjnë më herët për shkak të dy regjimeve të cilat kanë sunduar në dy shtetet. Gjatë shqyrtimit dhe në fjalën e tij të fundit e autorizuar e paditësve si dhe paditësi

EMR?
2 AKTE GJK.
2 FL. DEPO.
12.04 13
P.S.

1. 在下列各数中，找出所有的质数，并圈出来。
 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100.

2. 在下列各数中，找出所有的合数，并圈出来。
 4, 6, 8, 9, 10, 12, 14, 15, 16, 18, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 38, 39, 40, 42, 44, 45, 46, 48, 49, 50, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, 63, 64, 65, 66, 68, 69, 70, 72, 74, 75, 76, 77, 78, 80, 81, 82, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 96, 98, 99.

3. 在下列各数中，找出所有的偶数，并圈出来。
 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 28, 30, 32, 34, 36, 38, 40, 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64, 66, 68, 70, 72, 74, 76, 78, 80, 82, 84, 86, 88, 90, 92, 94, 96, 98, 100.

4. 在下列各数中，找出所有的奇数，并圈出来。
 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, 35, 37, 39, 41, 43, 45, 47, 49, 51, 53, 55, 57, 59, 61, 63, 65, 67, 69, 71, 73, 75, 77, 79, 81, 83, 85, 87, 89, 91, 93, 95, 97, 99.

H. [REDACTED] Ç. [REDACTED] kanë cekur se gjatë shoqërtimit është provuar se M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] ka pasur pasuri në Prizren dhe kjo është jokontestuese nga provat e administruara si dhe me dalje në vend është bërë identifikimi i palujtshmërisë e cila i ka takuar paraardhësit të paditësve. Gjithashtu është provuar se M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] është larguar nga Prizreni duke e lënë tërë pasurinë këtu dhe se për këtë ka kontribuar sistemi totalitar dhe konkretisht veprimtar i atëhershëm H. [REDACTED] V. [REDACTED] i cili këtë fakt e ka përshkruar në librin e tij "Mëngjezet pranverore të përgjakshme". Tani si pasojë kemi situatën që mos të ofrojmë prova të cilat për momentin kërkohen nga gjykata dhe të shkojmë me attribute përkatëse me emër e mbiemër si për sh. Si deklaroi ekspertja për çertifikatën e pronës e cila është e M. [REDACTED] Ç. [REDACTED]. Është fakt i ditur se palujtshmëritë e personave të përndjekur automatikisht janë bartë mbi Komunën. Andaj nisur nga ky fakt konsiderojmë se është e drejtë legjitime e paditësve që të kërkojnë pronën e tyre e cila i ka takuar babait të tyre. E drejta në kthimin e pronës nuk vjetërsohet dhe është e drejtë e shenjtë e paditësve. Këtë e garanton Kushtetuta e Kosovës si dhe Ligjet tjera të zbatueshme. Andaj konsiderojmë se gjykata duhet të aprovoj kërkesë padinë në tërësi si të bazuar dhe që njëherë e përgjithmonë paditësit të gëzojnë atë të drejtë dhe të zbatojnë amanetin e fundit të paraardhësit të tyre të shkruar në një letër dhe drejtuar qysh në atë kohë Sistemit Socialist në të cilën ka shprehur edhe dëshirën që ta sheh edhe një herë Prizrenin, vendin, lokalit dhe shtëpinë time si që është shprehur Mustafa Ç. [REDACTED] ka kërkuar shpenzimet në bazë të tarifës së avokatëve por nuk e ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurit në përgjegje në padë ka kontestuar padinë dhe kërkesë padinë fillimisht sa i përket vlerës së kontestit, faktit se padia nuk i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 102 të LPK është jo e plotë dhe e paqartë si dhe nga vet padia nuk është e kuartë se kush ia ka marrë pronën paditësit, në çfarë baze, nuk është i sakt legjitimacioni i palëve dhe kompetenca e saj aq më tepër kur kemi të bëjmë me palë me shtetësi të R të Shqipërisë dhe fitimi apo humbja e pronës së tyre eventuale nuk mund apo mund të ketë bazë juridike e cila në padë nuk përmendet. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i të paditësve ka cekur se pas administrimit të gjithë provave veçanërisht të ekspertës së gjeodezisë shihet qartë se Komuna nuk ka legjitimitet në këtë çështje pasi që bëhet fjalë për një palujtshmëri e cila qenka në shfrytëzimi dhe disponim të lirë të Kishës famullitare në Prizren kjo sipas aktgjykimit C.nr. 805/96 të vitit 1998 dhe nëse eventualisht gjykata konsideron se kemi legjitimitet në këtë çështje juridike kërkesat janë të vjetërsuara në kuptim të nenit 379 të LMD si dhe janë jo bindëse dhe të paargumentuara materialisht. Nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Vlerësimi i provave

Gjykata në procedurën e provave i administroi këto prova i ka dëgjuar dëshmitarët A. [REDACTED] Gj. [REDACTED] nga [REDACTED] dhe M. [REDACTED] Prizreni nga Kruma, S. [REDACTED] H. [REDACTED] nga Prizreni dhe V. [REDACTED] M. [REDACTED] nga Prizreni, ka bërë shiqimin në letrën e njoftimit të M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] lëshuar me dt. 01.11.1977, ka lexuar deklaratën e dhënë nga ana e M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] të vërtetuar te dhoma e noterve Kukës R e Shqipërisë, nr. 2233 dt. 29.03.2004, ka lexuar procesverbalin nr. 16 datës 08.05.1940 në të cilën regjistrohët nga ana e Sektorit të financave të ekonomisë M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] i është bllokuar malli dhe procesverbalin tjetër të dt. 15.10.1950 ka lexuar çertifikatën e Drejtorisë për çështje pronësoro juridike të Komunës së Prizrenit me dt. 07.03.2012 si dhe listën poseduese 8414 për parcelën 3305, ka lexuar aktin e shitblerjes të përpiluar në Prizren me datë 22.02.1944 si dhe deklaratën e bashkangjitur të M. [REDACTED] K. [REDACTED] me dt. 22.02.1944, ka lexuar vendimin nr. 216 të Gjykatës së Rethit të qytetit të Kukësit R e Shqipërisë me dt. 26.11.1951, ka lexuar dëshminë e Ministrisë së

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

2014

Drejtesise te Republikese Shqiperise ne Tiranë me dt. 02.11.1992, ka bërë shiqimin në çertifikatën e vdekjes së Zyres së gjendjes civile në Kukës me datë 26.03.2001 për M. Ç. , ka bërë shiqimin në fotografi të vjetër për të cilën paditësit deklarojnë se është e M. Ç. para lokalit të tij, ka lexuar ekspertizën e ekspertes së gjeodezisë L. R. dhe L. M. ekspertj ndërtimtarisë të dt. 22.06.2010, ka bërë shiqimin në çertifikatën familjare të Zyres së gjendjes civile Kukës me datë 04.10.2012 dhe 09.10.2012, ka bërë shiqimin në çertifikatën e vdekjes për F. Ç. të zyres së gjendjes civile Kukës me datë 18.10.2012, ka bërë shiqimin në vërtetimin për dhënien e statusit të Institutit të përndjekurve politik në Tiranë të Republikës së Shqipërisë me dt. 25.01.1999, ka lexuar ekspertizën e ekspertes së gjeodezisë L. R. me dt. 18.01.2013 si dhe ka dëgjuar plotësimin e ekspertizës në procesverbal me datë 28.02.2013.

Gjykata pas vlerësimit të gjithë këtyre provave secilës veç e veç dhe të gjitha bashkarisht i në kuptim të nenit 8 të LPC, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarëve A. Gj. M. Prizreni, S. H. dhe V. M. gjykata ka vërtetuar se të njëjtit e kanë njohur M. Ç. i lindur në Prizren dhe i përndjekur politikisht në Republikën e Shqipërisë i cili në ish Jugollavi ka punuar si tregëtar gjërë më vitin 1945. Dëshmitarët gjithashtu kanë deklaruar se M. Ç. e ka pasur dyqanin e tij përball shkollës "Bajram Curri" ku dëshmitari M. R. ka deklaruar se edhe ka punuar si shëgërt në të njëjtën. Gjithashtu ka deklaruar se në kohën kur është larguar në vitin 1944 M. Ç. së bashku me familjen e tij e ka lënë dyqanin e tij të mushur plotë me mall dhe të mbyllur. Më vonë i njëjti ka pësuar edhe nga Qeveria totalitare ku ka qenë dy herë i burgosur dhe i janë marrë sasi të konsiderueshme të napolonave flori. Sipas dëshmitarëve M. Ç. ka pasur edhe pasuri tjetër shtëpi e tokë, të cilat të gjitha i ka lënë dhe është larguar.

Me leximin e dokumentacionit të parashtruar: letrën e njoftimit të M. Ç. lëshuar me dt. 01.11.1977, deklaratën e dhënë nga ana e M. Ç. të vërtetuar te dhoma e noterve Kukës R e Shqipërisë nr. 2233 dt. 29.03.2004, procesverbalin nr. 16 datës 08.05.1940 në të cilën regjistrohet nga ana e Sektorit të financave të ekonomisë M. Ç. i është bllokuar malli dhe procesverbalin tjetër të dt. 15.10.1950, çertifikatën e Drejtorisë për çështje pronësoro juridike të Komunës së Prizrenit me dt. 07.03.2012 si dhe listën poseduese 8414 për parcelën 3305, aktin e shitblerjes të përpiluar në Prizren me datë 22.02.1944 si dhe deklaratën e bashkangjitur të M. K. me dt. 22.02.1944, vendimin nr. 216 të Gjykatës së Rethit të qytetit të Kukësit R e Shqipërisë me dt. 26.11.1951, dëshminë e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në Tiranë me dt. 02.11.1992, shiqimin në çertifikatën e vdekjes së Zyres së gjendjes civile në Kukës me datë 26.03.2001 për M. Ç. në fotografi të vjetër për të cilën paditësit deklarojnë se është e M. Ç. para lokalit të tij gjykata ka vërtetuar se M. Ç. me vendbanim në Kukës është larguar nga ish Jugosllavia në vitin 1944, në R të Shqipërisë si i përndjekur politikisht dhe me këtë rast e ka lënë dyqanin me dy podrume plotë me mall, shtëpinë në rrugën , një vnesht në vendin e quajtur " " të cilën e ka blerë nga Sh. H. V. dhe tokën arë ia ka lënë N. T. që të interesohet derisa ai të kthehet në Prizren, por e ka patur të vështirë pasi që edhe në Republikën e Shqipërisë dy herë është burgosur dhe ka përjetuar tortura çnjerëzore ku është dënuar 9 vjet me burg politik dhe 5 vjet internim. Për shitblerjen e vneshtës në vendin e quajtur " " është e përpiluar akt shitblerja në Prizren të cilën e ka verifikuar edhe deklaruesi M. K. me dt. 22.02.1944. Fakti se është burgosur politikisht në Shqipëri vërtetohet me vendim penal të Gjykatës së Rethit në Kukës dhe dëshmisë së bashkangjitur. Të gjithë këto na

92

vërtetoi faktin se M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] paraardhësi i paditësve ka qenë i përndjekur politikisht i cili tërë pasurinë e ka lënë në ish Jugosllavi dhe është detyruar që të largohet për në Republikën e Shqipërisë.

Me shiqimin në certifikatën familjare të zyrës së gjendjes civile Kukës me dt. 04.10.2012 dhe 09.10.2012 si dhe certifikatën e vdekjes për F. [REDACTED] Ç. [REDACTED] i dt. 18.10.2012 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit janë pasardhës të M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] të ndjerë i cili ka vdekur në Kukës dhe se F. [REDACTED] Ç. [REDACTED] ish nga Kukësi e cila ka vdekur në Kukës.

Me leximin e ekspertizës së ekspertës së gjeodezisë L. [REDACTED] R. [REDACTED] dhe L. [REDACTED] M. [REDACTED] të ndërtimtarisë të dt. 22.06.2010 dhe 18.01.2013 si dhe plotësim të ekspertizës në procesverbal të dt. 22.02.2013 si dhe certifikatës së Drejtorisë për çështje pronësoresh juridike gjeodezi dhe kadastrë në Prizren nr.023-63 dt. 07.03., gjykata vërtetoi se parcela kadastrale nr.3305 në rrugën [REDACTED] Kumanova të cilën paditësit pretendojnë që ka qenë lokali dhe podrumi i të ndjerit M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] evidentuar si shtëpi me oborr sipas listës pos. Nr. [REDACTED] në bazë të certifikatës së lartcekur vërtetohet se e njëjta është nacionalizuar me vendim të Komunës së Prizrenit nr.8690/398-59 prej dt. 18.11.1959 dhe ka kaluar në pronësi të Komunës së Prizrenit. Sipas ekspertizës së ekspertës së gjeodezisë fillimisht të dt. 22.06.2010 pas shiqimit në vend është vërtetuar se parcela kad. Nr. [REDACTED] evidentohet sipas listës pos.nr.8414 në rrugën [REDACTED] Kumanova nr. 10 deri 14 në të cilën ndodhet ndërtesa e vjetër e evidentuar në emër të Komunës së Prizrenit me këtë datë është vërtetuar se lokali nr. 12 dhe 14 për të cilën pretendojnë paditësit shfrytëzohen si lokal autoshkollë dhe shitore e autopjesëve. Sipas ekspertizës së datës 18.01.2013 sipas matjeve detale gjerë më vitin 1953-1957 parcela kontestuese kadastrale e cila gjendet në rrugën [REDACTED] Kumanova në sipërfaqe prej 26.25 ari evidentohet në emër të Zyres Famullitare të Kishës Katolike në Prizren fleta pos. Nr. 2250 ZK Prizren. Në vitin 1973 në bazë të aktvendimit mbi nacionalizim nr. 8690/398-59 dt. 18.11.1959 ndër të tjerat edhe parcela kadastrale 3305 kalon në emër të Komunës së Prizrenit sipas fletës pos. Nr. 8414 ZK Prizren. Në bazë të aktgjykimit C.nr.805/96 të dt. 19.05.1998 është vërtetuar se Zyra famullitare e Kishës katolike në Prizren është pronare e ndërtesave të cilat ndodhen në pjesën veriore të ngastrës kad. Nr. 3305 ZK Prizren dhe të njëjtat objekte me planet evidente janë të kufizuara me mure rrethues. Me rastin e daljes në vend paditësi H. [REDACTED] Ç. [REDACTED] bërë identifikimin e ish dyqanit e paraardhësit të tij dhe u konstatua se i njëjti gjindet në kuadrët të objektit dy katësh i cili ndodhet në anën lindore të ngastrës 3305 në rrugën [REDACTED] Kumanova dhe shfrytëzohet si lokal afarist të lëshuar me qira nga ana e Kishës Katolike në Prizren. Me plotësimin e ekspertizës ekspertja ka deklaruar se tani për tani palujtshmëria kontestuese është evidentuar në emër të Komunës së Prizrenit por shfrytëzuese është Zyra famullitare e Kishës katolike dhe se në lidhje me këtë palujtshmëri ka edhe dy konteste tjera në procedurë të veçantë dhe e njëjta gjithashtu është pjesë përbërse e ngastrës kad. Nr. 3305 e cila në pjesën veriore për atë pjesë ka përfunduar dhe ekszhiston aktgjykimi aprovues për Kishën Famullitare katolike në Prizren vitit 1998.

Vlerësimi juridik

Gjykata në rastin konkret pas administrimit të të gjitha provave ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon; nuk është kontestuese se paditësit janë pasardhës të M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] ish nga Prizreni i cili është larguar me dhunë nga ish Jugosllavia në vitin 1944 si i përndjekur politikisht. Nuk është kontestuese gjithashtu fakti se M. [REDACTED] Ç. [REDACTED] ka pësuar represione politike edhe në

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

1. 1. 1.

93
shtetin e Shqipërisë ku edhe ka qenë i denuar me burg. Nuk është kontestuese edhe fakti se M. [redacted]
Ç. [redacted] gjatë largimit nga Prizreni ka lënë tërë pasurinë e tij pa përkujdesje dhe në mëshir të fatit. E
gjithë kjo sipas provave të parashtruara dëshmitarëve vërtetohet, por është kontestuese dhe nuk
mund të vërtetohet se çka ka pasur si pasuri të veten M. [redacted] Ç. [redacted] dhe si mund të
identifikohet kjo pasuri. Sipas dëshmive ceket se ka pasur lokal në rrugën [redacted] përball
shkollës [redacted] Ç. [redacted] të cilën edhe pretendjnë paditësit që t'iu vërtetohet pronësia por për të
njëjtat nuk posedojnë ndonjë dokument valid i cili do të plotësonte dhe do të vërtetonte këtë
gjendje. Sipas ekspertizave të bëra të ekspertit të ngjeodezisë, ndërtimtarisë dhe certifikatës së
Drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër në Prizren vërtetohet fakti se palujtshmëria të cilën
pretendojnë paditësit se u takon atyre në vitin 1953-57 ka qenë e evidentuar në emër të Zyres
Famullitare të Kishës Katolike në Prizren. Më pas në vitin 1959 me aktvendim mbi nacionalizim e
njëjta ka kaluar në emër të Komunës së Prizrenit kurse sot është e evidentuar në Komunën e
Prizrenit por shfrytëzuese është Zyra Famullitare e Kishës Katolike në Prizren. Sa i përket
dokumentacionit tjetër ds prej vitit 1944 dhe gjerë më shenimet e matjes detale të vitit 1953-57
nuk ka shënime për të njëjtat. Nga e gjithë kjo gjykata konstaton se në asnjë dokument, në asnjë
periudhë kohore nuk parqitet emri i M. [redacted] Ç. [redacted] si pronar i mundshëm i kësaj palujtshmërie.
Sipas Ligjit mbi Marrdhëniet pronësoro juridike pronësia vërtetohet në bazë të certifikatës të
rëgjistruar në Regjistrin e drejtave në palujtshmëri neni 36 e cila në rastin konkret e vërteton faktin
se pronare e palujtshmërisë kontestuese është Komuna e Prizrenit. Andaj paditësit nuk mund të
jenë pronarë në mungesë të dokumentacionit përkatës.

Në bazë të lartëcekurave gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 452.1 të LPK pasi që
pala e humb kontestin obligohet që t'iu paguaj shpenzimet procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C.nr.385/01 të dt. 28.02.2013

Gjyqtarja

Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE; kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15
ditësh, pas marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.